

IDEJA QË SJELL NJË INTERSHIP TË PAGUAR. BASHKIA TIRANË E KTHEN NË TRADITË NISMËN QË BASHKON TEORINË ME PRAKTIKËN PËR TË RINJTË

Ndër nismat e shumta që mbështesin iniciativat rinore dhe zhvillimin e tyre, si kulturore ashtu dhe profesionale, një nga projektet që është kthyer në traditë në Bashkinë Tiranë është projekti i “Fillo me një Ide – Fito një Internship”, që ka hyrë në vitin e 6-të të zbatimit. Kjo iniciativë e rëndësishme synon të mbështesë të rinjtë në fillimet e karrierës së tyre profesionale. Projekti u ofron mundësinë të rinjve deri në moshën 28 vjeç për të fituar një praktikë të paguar në institucion, duke përgatitur dhe dorëzuar një propozim të plotë për një projekt ose studim. Praktika, e cila ka një periudhë 3-mujore, ofron mundësinë për të bashkëpunuar ngushtë me stafin e bashkisë dhe për të zhvilluar aftësi praktike në një mjedis profesional. Projekti inkurajon të rinjtë të paraqesin ide inovative, çka reflekton përkushtimin e Tiranës për të fuqizuar rininë dhe për t’i integruar ata në proceset vendimmarrëse dhe zhvillimore të qytetit, si dhe shfrytëzon kreativitetin e gjeneratave të reja dhe promovon qytetarinë aktive.

Nisma është në përputhje të plotë me kapitujt 19 dhe 26 për zgjerim të Bashkimit Europian që flet për politikën për punësimin dhe shkollimin. Duke ofruar mundësi për praktika të paguara dhe përvojë të drejtpërdrejtë në institucione, projekti kontribuon në uljen e papunësisë tek të rinjtë dhe rrit punësueshmërinë përmes përvojës praktike.



Kapitulli 26 i “acquis” të BE fokusohet në zhvillimin e politikave të edukimit dhe kulturës, për të mbështetur rritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e një shoqërie të informuar dhe të angazhuar. Projekti ofron mundësi për të rinjtë që të përfitojnë nga një periudhë praktike e lidhur me konceptet e tyre të edukimit dhe studimit, duke ofruar një urë mes teorisë dhe praktikës.

Tirana është e fokusuar në të qenit një qytet më modern, inovativ dhe “i zgjuar”(smart). Një projekt që inkurajon të rinjtë të propozojnë ide të reja përshtatet në mënyrë të përkryer me këtë vizion, pasi mund të sjellë perspektiva të reja dhe zgjidhje potenciale për sfidat lokale. Inovacioni nga të rinjtë mund të çojë në përmirësime praktike në fusha si infrastruktura, shërbimet publike, qëndrueshmëria dhe çështjet sociale, duke kontribuar në strategjinë e përgjithshme të zhvillimit të bashkisë.

Nisma promovon angazhimin qytetar duke inkurajuar popullsinë e re të marrë pjesë në procesin e qeverisjes, çka është në përputhje me theksin që Tirana i vë qeverisjes përfshirëse dhe pjesëmarrëse. Nxitja e ideve nga grupe të ndryshme siguron përfaqësim më të gjerë të nevojave dhe interesave sociale, duke bërë që puna e bashkisë të jetë më reflektuese ndaj të gjithë komunitetit.

Duke ftuar ide për përmirësim, bashkia mund të përdorë zgjidhje lokale që mund të kontribuojnë në qëllimet e saj për qëndrueshmëri dhe mirëqenie sociale për të mbështetur talentin vendas që mund të kontribuojë në të ardhmen e Tiranës.

